

THIRRJE PËR PROPOZIME

Grante për OShC-të që avokojnë për angazhimin e grave të reja në politikë dhe institucionet publike

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) dhe Qendra për Këshillim dhe Mbështetje për Gratë (Dora Dorës)

Rreth Qendrës Kosovare për Studime Gjinore dhe Dora Dorës

Qendra Kosovare për Studime Gjinore synon të integrojë analiza, programe dhe politika të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore në të gjithë sektorët e shoqërisë kosovare, duke rritur ndërgjegjësimin gjinor dhe fokusin në çështjet gjinore, duke zhvilluar studime gjinore dhe duke siguruar përfshirjen e politikave të ndjeshme ndaj çështjeve gjinore përmes hulumtimit shkencor, zhvillimit të politikave, avokimit dhe lobimit. Mjetet dhe praktikatat e avancuara të avokimit, monitorimi efektiv i zbatimit të ligjeve përmes hulumtimeve dhe vëzhgimeve të gjera, rritja e ndërgjegjësit të grupeve të synuara kanë qenë disa nga instrumentet e aplikuara nga QKSGJ-ja në të kaluarën.

Qendra për Këshillim dhe Mbështetje për Gratë (Dora Dorës) është organizatë joqeveritare e grave e formuar në vitin 2002 nga gratë me përgatitje profesionale në shkencat sociale në rajonin e Prizrenit. Misioni i ndërmarrë nga Qendra për Këshillim dhe Mbështetje për Gratë (Dora Dorës) konsiston në rritjen e pjesëmarrjes aktive të komunitetit të grave në proceset vendimmarrëse.

Thirrje për propozime

Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), në bashkëpunim me organizatën e saj partnere në projekt, Qendrën për Këshillim dhe Mbështetje për gratë (Dora Dorës), po zbaton projektin e financuar nga BE-ja "Gratë e reja të përfshira në partitë politike dhe në proceset politike" dhe ka kënaqësinë të shpallë **thirrjen për propozime për grante për OShC-të që avokojnë për angazhimin e grave të reja në politikë dhe jetë publike**. Grante deri në 5000 euro do të jepen për të paktën nëntë (9) organizata për të avokuar për zbatimin e ligjit për barazi gjinore. Grantet do të jepen në bazë të konkursit.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është që të promovojë zbatimin e plotë të Ligjit për Barazi Gjinore dhe Kundër Diskriminimit të Grave përmes përmirësimit të pjesëmarrjes së tyre në politikë dhe në pozita vendimmarrëse në institucionet publike. Projekti do të prodhojë rezultate dhe ndikim të qëndrueshëm, pasi synon kanalizimin e ndryshimit përmes tri akteve kryesore: forcimi i kapaciteteve të OJQ-ve lokale të grave që të luajnë rolin e tyre të mbikëqyrjes dhe avokimit; rritja e aftësisë për të mobilizuar anëtarësinë dhe aktivistët përmes grave të reja të



trajnuara; dhe rritja e dukshmërisë dhe shtrirjes së OJQ-ve lokale të grave përmes dukshmërisë dhe pranisë më të madhe në terren.

Projekti do të përpiqet të arrijë objektivat specifike të mëposhtme:

- Rritje e pjesëmarrjes së grave të reja si votuese dhe udhëheqëse në Kosovë dhe rajonin e Prizrenit në veçanti;
- Ngritja e kapaciteteve të grave të reja për të konkurruar me sukses në politikë dhe institucionet publike;
- Përmirësimi i politikave që nxisin përfshirje më të madhe të grave;
- Gjenerimi i dëshmime mbi sfidat me të cilat përballen gratë e reja në pjesëmarrjen politike për programimin e ardhshëm të Qeverisë dhe të institucioneve joqeveritare;
- Ngritja e vetëdijes për rëndësinë e pjesëmarrjes së plotë të grave në skenën publike dhe politike.

Aplikimi

Prioritet do t'u jepet organizatave rinore, propozimet e të cilave janë të përqendruara në çështjet gjinore që lidhen me këtë projekt, dhe organizatave të cilat planifikojnë të kryejnë fushata, avokim dhe hulumtim. Për të aplikuar për grant, organizata aplikuese duhet të dorëzojë:

- 1) Formularin e aplikimit.
- 2) Formularin e Buxhetit, i cili duhet të përfshijë shpenzimet e detajuara të buxhetit për zbatimin e projektit. Buxheti duhet të projektohet në përputhje me aktivitetet e propozuara në aplikim;
- 3) Dokumentin e regjistrimit - Dëshmia e regjistrimit të organizatës duhet t'i bashkëngjitet propozimit;
- 4) CV-të e personelit të propozuar.

Afati përfundimtar i aplikimit

Organizatave të interesuara duhet t'i dorëzojnë dokumentet e mëposhtme deri të premten, **16 qershor 2017**.

Aplikimet mund të dorëzohen në shqip, anglisht ose serbisht.

Shënim: Aplikimi duhet të dorëzohet duke përdorur formularin e ofruar të aplikimit dhe buxhetit të QKSGJ-së dhe Dora-Dorës, dhe duhet të dërgohet nëpërmjet postës elektronike në: info@kgscenter.net me subjekt: **Grante avokimi për gra të reja në institucionet politike dhe publike**.

Përzgjedhja përfundimtare do të bëhet nga anëtarët e zgjedhur të komisionit të vlerësimit dhe do të shpallet deri më **28 qershor 2017**.

